Blv. Zhan d'Ark, nr. 3
Tiranë, 1001
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2228300

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Anketa Tremujore e Forcave të Punës

## Tremujori I 2018

**Tiranë, më 11 qershor 2018:** Në tremujorin e parë 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,2 %. Gjatë këtij tremujori, në terma vjetorë punësimi shfaq tendencë në rritje: krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, punësimi u rrit me 4,9 %. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017, punësimi pësoi një rritje prej 0,8 %.

Në tremujorin e parë 2018, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 12,5 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 1,7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e katërt 2017, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rënie prej 0,9 pikë përqindje.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 68 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 2 pikë përqindje më e lartë. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm ky tregues është rritur me 0,5 pikë përqindje.

Fig. 1 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç, Tr. 1/15 - Tr. 1/18




Për gratë, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 59,5 %, ndërsa për burrat ky tregues është 76,6 %. Për burrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 17,1 pikë përqindje më e lartë sesa për gratë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për gratë është rritur me 2,9 pikë përqindje dhe për burrat me 1,6 pikë përqindje.

**Për publikim 11/06/2016**

*Vijon*

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 47,5 %. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e parë 2018, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 79,1 %.

**Punësimi**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,2 %.

Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart është 4,9 %. Në terma vjetorë, rritja e punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë është: 7,1 % në sektorin e industrisë, 6,7 % në sektorin e shërbimeve dhe 1,2 % në sektorin e bujqësisë.

Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, në tremujorin e parë 2018, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart pësoi një rritje prej 0,8 %. Punësimi u rrit në sektorin e shërbimeve me 1,4 % dhe në sektorin bujqësor me 1,1 %. Ndërsa në sektorin e industrisë punësimi pësoi një rënie prej 1,1 %.

Fig. 2 Ritmi vjetor dhe tremujor i rritjes së punësimit, për popullsinë 15 vjeç e lart




Shkalla e punësimit për burrat është 66,5 %, ndërsa për gratë 51,9 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, shkalla e punësimit për burrat është rritur me 3,6 pikë përqindje dhe për gratë me 2,4 pikë përqindje. Shkalla e punësimit të të rinjve është 35,9 %. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e parë 2018, shkalla e punësimit është 71,9 %.

## Fig. 3 Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç, Tr. 1/15 - Tr. 1/18




**Papunësia**

Në tremujorin e parë 2018, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 12,5 %. Në terma vjetorë, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 1,7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,9 pikë përqindje.

Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat është 12,6 % dhe për gratë është 12,3 %. Shkalla e papunësisë për gratë është 0,3 pikë përqindje më e ulët sesa për burrat. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017, shkalla e papunësisë për burrat ka rënë me 3 pikë përqindje, ndërsa për gratë mbetet thuajse në të njëjtin nivel.

## Fig. 4 Shkalla zyrtare e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, Tr. 1/15 - Tr. 1/18



Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 24,5 %. Në terma vjetorë shkalla e papunësisë së të rinjve shfaq tendencë në rënie. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e parë të vitit 2018 është 2,1 pikë përqindje më e ulët. Krahasuar me tremujorin e katërt 2017, shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar një rënie prej 0,1 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30-64 vjeç është 9,2 %. Në terma vjetorë ky tregues pësoi një rënie prej 2 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm për këtë grup-moshë shkalla e papunësisë u ul me 1,3 pikë përqindje.

**Popullsia ekonomikisht jo-aktive**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, 21,5 % e popullsisë ekonomikisht jo-aktive dhe në moshë pune (15-64 vjeç) ishin duke përmbushur detyrat shtëpiake, 11,3 % e saj ishte në pension ose pension të parakohshëm, ndërsa 8,7 % në paaftësi të përhershme.

Gjatë tremujorit të parë 2018, 8,9 % e popullsisë ekonomikisht jo-aktive (në grup-moshën 15-64 vjeç) deklaruan se nuk po kërkonin punë pasi besonin se nuk ka punë të disponueshme, pra klasifikohen si të papunë të dekurajuar.

Fig. 5 Struktura e popullsisë ekonomikisht jo-aktive sipas gjinisë dhe statusit




Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 68,4 % të të rinjve ekonomikisht jo-aktivë. Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomikisht jo-aktivë, 8,2 % klasifikohen si të papunë të dekurajuar. Në popullsinë e moshës 30-64 vjeç ky grup përbën 9,7 % të popullsisë ekonomikisht jo-aktive të kësaj grup-moshe.

## Tab. 1 Shkalla e papunësisë Tr.1/14 - Tr.1/18

| Mosha | Gjinia | Tr.1.2014 | Tr.2.2014 | Tr.3.2014 | Tr.4.2014 | Tr.1.2015 | Tr.2.2015 | Tr.3.2015 | Tr.4.2015 | Tr.1.2016 | Tr.2.2016 | Tr.3.2016 | Tr.4.2016 | Tr.1.2017 | Tr.2.2017 | Tr.3.2017 | Tr.4.2017 | Tr.1.2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 vjeç e lart | Gjithsej | 18,2 | 17,2 | 17 | 17,6 | 16,9 | 17,0 | 17,2 | 17,3 | 16,6 | 15,5 | 14,7 | 14,2 | 14,2 | 13,9 | 13,6 | 13,4 | 12,5 |
| | Burra | 19,4 | 19,3 | 19,1 | 18,9 | 17,2 | 17,1 | 17,0 | 17,0 | 17,4 | 16,4 | 15,3 | 14,5 | 15,6 | 14,9 | 14,3 | 13,7 | 12,6 |
| | Gra | 16,4 | 14,4 | 14,2 | 15,8 | 16,5 | 16,9 | 17,5 | 17,8 | 15,5 | 14,2 | 14,0 | 13,7 | 12,2 | 12,5 | 12,6 | 12,9 | 12,3 |
| 15-64 vjeç | Gjithsej | 18,6 | 17,7 | 17,4 | 18,0 | 17,3 | 17,3 | 17,5 | 17,7 | 16,9 | 15,9 | 15,2 | 14,5 | 14,6 | 14,3 | 14,0 | 13,6 | 13,0 |
| | Burra | 19,9 | 19,8 | 19,6 | 19,4 | 17,7 | 17,5 | 17,4 | 17,5 | 17,8 | 17,0 | 15,9 | 15,0 | 16,1 | 15,4 | 14,8 | 14,1 | 13,2 |
| | Gra | 16,8 | 14,7 | 14,5 | 16,1 | 16,8 | 17,2 | 17,7 | 18,1 | 15,8 | 14,5 | 14,3 | 13,9 | 12,5 | 12,8 | 12,8 | 13,0 | 12,7 |
| 15-29 vjeç | Gjithsej | 30,2 | 33,5 | 32,4 | 33,9 | 34,1 | 34,2 | 32,3 | 32,2 | 30,4 | 29,9 | 27,4 | 28,1 | 26,6 | 26,4 | 26,0 | 24,6 | 24,5 |
| | Burra | 33,0 | 37,1 | 35,7 | 36,5 | 33,5 | 33,3 | 31,0 | 31,6 | 30,7 | 31,2 | 27,7 | 29,3 | 28,6 | 27,4 | 26,6 | 25,6 | 24,2 |
| | Gra | 25,4 | 27,1 | 26,9 | 29,7 | 35,1 | 35,9 | 34,8 | 33,1 | 30,1 | 28,0 | 26,9 | 26,2 | 23,4 | 24,7 | 25,0 | 23,1 | 24,9 |
| 30-64 vjeç | Gjithsej | 15,1 | 12,8 | 12,4 | 12,8 | 12 | 12,1 | 12,9 | 13,1 | 12,9 | 11,9 | 11,7 | 10,6 | 11,2 | 10,8 | 10,6 | 10,5 | 9,2 |
| | Burra | 15,5 | 13,8 | 13,6 | 13,3 | 12,3 | 11,9 | 12,4 | 12,4 | 13,5 | 12,6 | 12,1 | 10,5 | 12,3 | 11,5 | 11,1 | 10,6 | 9,3 |
| | Gra | 14,6 | 11,5 | 11,0 | 12,3 | 11,6 | 12,5 | 13,4 | 13,9 | 12,2 | 11,0 | 11,1 | 10,7 | 9,8 | 9,9 | 10,0 | 10,4 | 9,0 |

## Tab. 2 Shkalla e punësimit Tr.1/14 - Tr.1/18

| Mosha | Gjinia | Tr.1.2014 | Tr.2.2014 | Tr.3.2014 | Tr.4.2014 | Tr.1.2015 | Tr.2.2015 | Tr.3.2015 | Tr.4.2015 | Tr.1.2016 | Tr.2.2016 | Tr.3.2016 | Tr.4.2016 | Tr.1.2017 | Tr.2.2017 | Tr.3.2017 | Tr.4.2017 | Tr.1.2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 vjeç e lart | Gjithsej | 41,5 | 44,4 | 45,8 | 45,6 | 45,6 | 45,8 | 46,3 | 46,7 | 47,5 | 48,4 | 49,9 | 49,1 | 49,2 | 50,0 | 50,7 | 51,2 | 51,9 |
| | Burra | 48,3 | 52,2 | 52,7 | 52,3 | 52,5 | 53,0 | 54,1 | 53,4 | 53,1 | 54,0 | 56,1 | 55,4 | 55,6 | 56,7 | 57,7 | 58,2 | 58,9 |
| | Gra | 34,9 | 37,1 | 39,2 | 39,3 | 39,0 | 38,9 | 38,5 | 39,9 | 41,9 | 42,8 | 43,7 | 42,8 | 42,7 | 43,4 | 43,8 | 44,2 | 45,0 |
| 15-64 vjeç | Gjithsej | 47,1 | 50,5 | 52,3 | 52,1 | 52,1 | 52,7 | 53,3 | 53,7 | 54,8 | 55,3 | 57,1 | 56,2 | 56,3 | 57,3 | 57,7 | 58,2 | 59,2 |
| | Burra | 54,4 | 58,7 | 59,7 | 59,2 | 59,4 | 60,5 | 61,4 | 60,7 | 60,4 | 61,1 | 63,4 | 62,8 | 62,9 | 64,1 | 64,7 | 65,6 | 66,5 |
| | Gra | 39,9 | 42,7 | 45,4 | 45,4 | 45,1 | 45,2 | 45,0 | 46,5 | 49,0 | 49,6 | 50,8 | 49,6 | 49,5 | 50,3 | 50,5 | 50,8 | 51,9 |
| 15-29 vjeç | Gjithsej | 25,8 | 27,5 | 30,5 | 29,2 | 28,9 | 28,6 | 30,4 | 31,1 | 32,1 | 31,6 | 33,5 | 32,5 | 33,0 | 33,6 | 33,5 | 34,9 | 35,9 |
| | Burra | 30,2 | 32,8 | 35,4 | 33,7 | 33,6 | 35,1 | 38,0 | 36,3 | 36,5 | 34,8 | 37,9 | 35,9 | 36,9 | 38,4 | 39,2 | 39,7 | 41,6 |
| | Gra | 21,1 | 22,1 | 25,5 | 24,5 | 23,9 | 21,6 | 21,9 | 25,2 | 27,0 | 28,0 | 28,4 | 28,6 | 28,4 | 28,1 | 26,9 | 29,7 | 29,8 |
| 30-64 vjeç | Gjithsej | 59,4 | 62,9 | 64,1 | 64,5 | 64,4 | 65,4 | 65,4 | 65,6 | 65,7 | 66,8 | 68,5 | 67,8 | 67,5 | 68,6 | 69,3 | 69,4 | 71,9 |
| | Burra | 69,4 | 73,5 | 73,7 | 74,0 | 74,4 | 75,3 | 74,9 | 74,6 | 73,0 | 74,8 | 76,7 | 77,0 | 76,6 | 77,8 | 78,1 | 79,0 | 80,6 |
| | Gra | 50,0 | 53,2 | 55,3 | 55,9 | 55,4 | 56,6 | 56,3 | 56,9 | 58,6 | 59,2 | 60,6 | 58,9 | 58,7 | 60,0 | 60,9 | 60,3 | 63,5 |

**Tab. 3 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës Tr.1/13 - Tr.1/18**

| Mosha | Gjinia | Tr.1.2014 | Tr.2.2014 | Tr.3.2014 | Tr.4.2014 | Tr.1.2015 | Tr.2.2015 | Tr.3.2015 | Tr.4.2015 | Tr.1.2016 | Tr.2.2016 | Tr.3.2016 | Tr.4.2016 | Tr.1.2017 | Tr.2.2017 | Tr.3.2017 | Tr.4.2017 | Tr.1.2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 vjeç e lart | Gjithsej | 50,8 | 53,6 | 55,2 | 55,3 | 54,8 | 55,2 | 55,9 | 56,8 | 56,9 | 57,2 | 58,5 | 57,2 | 57,3 | 58,1 | 58,7 | 59,1 | 59,3 |
| | Burra | 59,9 | 64,7 | 65,1 | 64,5 | 63,4 | 63,9 | 65,1 | 64,7 | 64,3 | 64,7 | 66,3 | 64,8 | 66,0 | 66,6 | 67,3 | 67,4 | 67,4 |
| | Gra | 41,8 | 43,3 | 45,8 | 46,7 | 46,7 | 46,8 | 46,6 | 48,9 | 49,5 | 49,9 | 50,8 | 49,5 | 48,6 | 49,6 | 50,1 | 50,8 | 51,3 |
| 15-64 vjeç | Gjithsej | 57,9 | 61,3 | 63,4 | 63,6 | 63,0 | 63,7 | 64,7 | 65,3 | 65,9 | 65,8 | 67,3 | 65,7 | 65,9 | 66,8 | 67,1 | 67,4 | 68,0 |
| | Burra | 68,0 | 73,2 | 74,2 | 73,5 | 72,2 | 73,3 | 74,4 | 73,5 | 73,4 | 73,5 | 75,3 | 73,8 | 75,0 | 75,7 | 76,0 | 76,4 | 76,6 |
| | Gra | 47,9 | 50,1 | 53,0 | 54,1 | 54,2 | 54,6 | 54,7 | 56,8 | 58,2 | 58,1 | 59,2 | 57,6 | 56,6 | 57,7 | 58,0 | 58,4 | 59,5 |
| 15-29 vjeç | Gjithsej | 36,9 | 41,4 | 45,1 | 44,2 | 43,9 | 43,4 | 45,0 | 45,9 | 46,2 | 45,0 | 46,1 | 45,2 | 44,9 | 45,7 | 45,2 | 46,3 | 47,5 |
| | Burra | 45,1 | 52,2 | 55,0 | 53,0 | 50,5 | 52,5 | 55,1 | 53,1 | 52,7 | 50,6 | 52,5 | 50,8 | 51,6 | 52,9 | 53,4 | 53,3 | 54,9 |
| | Gra | 28,2 | 30,3 | 34,9 | 34,9 | 36,7 | 33,6 | 33,5 | 37,7 | 38,6 | 38,9 | 38,8 | 38,8 | 37,1 | 37,3 | 35,9 | 38,6 | 39,7 |
| 30-64 vjeç | Gjithsej | 69,9 | 72,1 | 73,2 | 74,0 | 73,2 | 74,4 | 75,1 | 75,5 | 75,4 | 75,8 | 77,5 | 75,8 | 76,0 | 76,9 | 77,5 | 77,6 | 79,1 |
| | Burra | 82,1 | 85,3 | 85,3 | 85,3 | 84,8 | 85,4 | 85,5 | 85,2 | 84,4 | 85,6 | 87,3 | 86,0 | 87,3 | 87,9 | 87,8 | 88,3 | 88,9 |
| | Gra | 58,6 | 60,1 | 62,2 | 63,7 | 62,6 | 64,7 | 65,1 | 66,1 | 66,7 | 66,5 | 68,1 | 66,0 | 65,1 | 66,6 | 67,7 | 67,3 | 69,8 |

# Treguesit e tregut të punës sipas qarqeve

## Tab. 4 Treguesit kryesorë të tregut të punës, popullsia 15 vjeç e lart

| Qarqet | Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës | | | | | | | | Shkalla e punësimit | | | | | | | | Shkalla e papunësisë | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 |
| Shqipëria | 57,3 | 58,5 | 57,2 | 57,3 | 58,1 | 58,7 | 59,1 | 59,3 | 48,4 | 49,9 | 49,1 | 49,2 | 50,0 | 50,7 | 51,2 | 51,9 | 15,5 | 14,7 | 14,2 | 14,2 | 13,9 | 13,6 | 13,4 | 12,5 |
| Berat | 58,8 | 62,7 | 58,4 | 57,3 | 59,7 | 59,4 | 61,1 | 63,0 | 53,6 | 57,2 | 51,9 | 49,5 | 51,6 | 52,5 | 53,2 | 57,4 | 8,9 | 8,7 | 11,1 | 13,7 | 13,5 | 11,7 | 12,8 | 8,8 |
| Dibër | 54,7 | 60,4 | 59,2 | 60,4 | 60,6 | 59,8 | 58,9 | 63,6 | 50,3 | 55,6 | 53,9 | 54,9 | 56,6 | 55,8 | 54,8 | 59,8 | 8,1 | 7,9 | 8,9 | 9,1 | 6,7 | 6,7 | 7,0 | 6,0 |
| Durrës | 53,6 | 53,6 | 53,3 | 51,4 | 52,1 | 51,2 | 52,9 | 53,1 | 45,7 | 45,2 | 46,3 | 44,8 | 46,4 | 45,2 | 46,4 | 46,3 | 14,7 | 15,6 | 13,2 | 12,9 | 10,8 | 11,9 | 12,2 | 12,7 |
| Elbasan | 66,8 | 68,3 | 67,2 | 68,9 | 67,5 | 68,5 | 66,4 | 66,5 | 57,2 | 59,8 | 58,5 | 61,0 | 60,2 | 62,6 | 61,0 | 61,8 | 14,4 | 12,4 | 12,9 | 11,5 | 10,8 | 8,5 | 8,2 | 7,1 |
| Fier | 62,8 | 63,2 | 63,0 | 62,3 | 64,1 | 63,6 | 64,1 | 67,2 | 54,9 | 54,7 | 54,5 | 54,2 | 54,7 | 54,8 | 55,1 | 60,5 | 11,9 | 13,5 | 13,5 | 13,0 | 14,6 | 13,8 | 14,0 | 10,0 |
| Gjirokastër | 62,0 | 57,6 | 56,7 | 57,9 | 57,3 | 60,0 | 59,7 | 58,9 | 53,4 | 50,3 | 51,0 | 51,7 | 49,9 | 52,1 | 52,4 | 53,5 | 13,8 | 12,7 | 10,0 | 10,6 | 12,9 | 13,1 | 12,3 | 9,2 |
| Korçë | 54,1 | 57,9 | 52,3 | 52,3 | 53,7 | 58,5 | 58,6 | 58,6 | 48,7 | 52,9 | 48,3 | 48,1 | 49,6 | 54,2 | 54,2 | 55,0 | 9,9 | 8,6 | 7,7 | 8,1 | 7,6 | 7,3 | 7,5 | 6,1 |
| Kukës | 48,3 | 55,8 | 54,5 | 55,2 | 58,7 | 57,1 | 57,0 | 55,9 | 39,3 | 46,7 | 46,7 | 46,7 | 50,4 | 49,6 | 50,1 | 50,8 | 18,7 | 16,3 | 14,3 | 15,4 | 14,2 | 13,2 | 12,0 | 9,2 |
| Lezhë | 56,1 | 56,8 | 55,8 | 56,1 | 56,9 | 56,8 | 54,9 | 54,1 | 48,1 | 48,3 | 47,8 | 47,0 | 47,0 | 47,4 | 46,0 | 44,3 | 14,3 | 14,9 | 14,5 | 16,2 | 17,5 | 16,6 | 16,1 | 18,2 |
| Shkodër | 59,5 | 57,6 | 57,3 | 59,1 | 60,2 | 60,7 | 61,1 | 63,8 | 51,3 | 51,6 | 49,5 | 51,8 | 52,5 | 53,1 | 53,5 | 55,0 | 13,9 | 10,4 | 13,6 | 12,4 | 12,7 | 12,5 | 12,4 | 13,9 |
| Tiranë | 53,0 | 54,4 | 53,6 | 54,1 | 54,5 | 55,3 | 55,9 | 55,0 | 42,6 | 43,8 | 44,5 | 44,7 | 45,6 | 45,9 | 47,0 | 46,7 | 19,5 | 19,5 | 16,9 | 17,4 | 16,3 | 17,0 | 16,1 | 15,0 |
| Vlorë | 62,1 | 60,2 | 58,4 | 56,2 | 58,6 | 58,6 | 62,6 | 61,4 | 45,7 | 46,4 | 44,9 | 43,4 | 44,4 | 44,2 | 47,7 | 46,4 | 26,4 | 22,9 | 23,1 | 22,7 | 24,3 | 24,6 | 23,9 | 24,5 |

## Tab. 5 Treguesit kryesorë të tregut të punës, popullsia 15-64 vjeç

| Qarqet | Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës | | | | | | | | Shkalla e punësimit | | | | | | | | Shkalla e papunësisë | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 |
| Shqipëria | 65,8 | 67,3 | 65,7 | 65,9 | 66,8 | 67,1 | 67,4 | 68,0 | 55,3 | 57,1 | 56,2 | 56,3 | 57,3 | 57,7 | 58,2 | 59,2 | 15,9 | 15,2 | 14,5 | 14,6 | 14,3 | 14,0 | 13,6 | 13,0 |
| Berat | 67,6 | 71,0 | 66,2 | 65,4 | 68,4 | 67,5 | 69,7 | 71,5 | 61,3 | 64,5 | 58,5 | 56,0 | 58,8 | 59,3 | 60,4 | 64,8 | 9,2 | 9,2 | 11,6 | 14,3 | 14,0 | 12,2 | 13,4 | 9,4 |
| Dibër | 62,2 | 68,6 | 66,4 | 68,8 | 68,6 | 66,4 | 66,3 | 68,7 | 56,9 | 62,8 | 60,2 | 62,3 | 63,7 | 61,7 | 61,6 | 64,4 | 8,5 | 8,3 | 9,3 | 9,5 | 7,1 | 7,2 | 7,0 | 6,4 |
| Durrës | 62,7 | 62,8 | 62,5 | 60,2 | 61,1 | 59,9 | 62,0 | 63,0 | 53,5 | 52,9 | 54,2 | 52,4 | 54,5 | 52,8 | 54,4 | 54,9 | 14,8 | 15,7 | 13,2 | 13,0 | 10,8 | 11,9 | 12,2 | 12,8 |
| Elbasan | 75,1 | 76,7 | 75,8 | 77,5 | 76,2 | 76,4 | 74,1 | 72,7 | 63,6 | 66,7 | 65,5 | 68,2 | 67,6 | 69,4 | 68,0 | 67,0 | 15,2 | 13,1 | 13,6 | 12,0 | 11,4 | 9,1 | 8,2 | 7,8 |
| Fier | 71,2 | 72,0 | 71,8 | 70,4 | 72,1 | 71,4 | 72,2 | 76,4 | 61,8 | 61,9 | 61,6 | 60,7 | 60,9 | 60,9 | 61,6 | 68,4 | 12,4 | 14,1 | 14,1 | 13,7 | 15,5 | 14,6 | 14,8 | 10,5 |
| Gjirokastër | 72,5 | 67,2 | 64,8 | 67,4 | 67,1 | 68,9 | 68,3 | 69,2 | 62,3 | 58,5 | 58,0 | 60,1 | 58,3 | 59,6 | 59,6 | 62,6 | 14,0 | 12,9 | 10,4 | 10,8 | 13,0 | 13,6 | 12,7 | 9,5 |
| Korçë | 60,8 | 65,2 | 60,0 | 59,9 | 61,7 | 67,0 | 66,8 | 67,1 | 54,5 | 59,3 | 55,2 | 54,9 | 56,8 | 61,9 | 61,9 | 62,9 | 10,5 | 9,1 | 7,9 | 8,4 | 7,9 | 7,6 | 7,4 | 6,3 |
| Kukës | 57,2 | 66,1 | 63,3 | 65,5 | 69,8 | 67,7 | 66,9 | 66,9 | 46,5 | 55,2 | 55,4 | 55,4 | 59,9 | 58,7 | 59,4 | 61,2 | 18,8 | 16,4 | 12,5 | 15,4 | 14,3 | 13,3 | 11,1 | 8,4 |
| Lezhë | 64,6 | 64,8 | 63,9 | 63,0 | 64,5 | 63,9 | 62,2 | 62,6 | 55,1 | 54,8 | 54,4 | 52,2 | 52,7 | 52,7 | 51,7 | 50,7 | 14,7 | 15,5 | 15,0 | 17,1 | 18,3 | 17,5 | 16,8 | 19,0 |
| Shkodër | 68,1 | 65,7 | 64,3 | 67,2 | 69,3 | 69,4 | 68,7 | 72,2 | 58,3 | 58,5 | 55,1 | 58,5 | 60,2 | 60,4 | 59,7 | 61,6 | 14,4 | 10,9 | 14,2 | 12,9 | 13,1 | 13,0 | 13,1 | 14,7 |
| Tiranë | 61,8 | 63,8 | 62,7 | 63,4 | 63,5 | 64,2 | 64,8 | 64,2 | 49,7 | 51,3 | 52,1 | 52,2 | 53,0 | 53,3 | 54,3 | 54,4 | 19,6 | 19,5 | 17,0 | 17,5 | 16,4 | 16,9 | 16,1 | 15,2 |
| Vlorë | 71,4 | 69,7 | 68,3 | 65,6 | 66,9 | 67,1 | 71,0 | 70,0 | 52,0 | 53,5 | 52,3 | 50,5 | 50,4 | 50,2 | 53,4 | 52,0 | 27,1 | 23,3 | 23,4 | 23,0 | 24,7 | 25,3 | 24,8 | 25,7 |

**Tab. 6 Struktura e punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë, popullsia 15 vjeç e lart (%)**

| Qarqet | Bujqësi | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr1.16 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 |
| Shqipëria | 40,7 | 40,4 | 40,1 | 39,7 | 39,0 | 38,4 | 37,9 | 37,6 | 37,7 |
| Berat | 65,8 | 62,8 | 61,3 | 59,2 | 55,7 | 56,0 | 52,5 | 52,7 | 61,5 |
| Dibër | 70,9 | 73,3 | 68,6 | 64,5 | 57,4 | 59,4 | 61,1 | 57,3 | 62,4 |
| Durrës | 25,0 | 20,6 | 20,7 | 23,5 | 20,1 | 16,7 | 14,8 | 15,9 | 14,7 |
| Elbasan | 63,2 | 65,4 | 65,8 | 63,9 | 64,8 | 64,9 | 63,8 | 62,0 | 68,2 |
| Fier | 65,1 | 60,6 | 58,9 | 63,7 | 63,5 | 61,9 | 61,7 | 62,0 | 63,6 |
| Gjirokastër | 40,3 | 44,0 | 47,1 | 47,2 | 44,6 | 51,3 | 41,0 | 40,9 | 40,0 |
| Korçë | 58,5 | 58,6 | 59,3 | 57,7 | 55,8 | 49,8 | 52,9 | 52,5 | 51,8 |
| Kukës | 68,4 | 72,0 | 73,0 | 66,7 | 61,6 | 58,3 | 63,8 | 58,3 | 62,6 |
| Lezhë | 35,7 | 36,7 | 40,8 | 40,1 | 45,1 | 45,8 | 39,2 | 35,9 | 33,9 |
| Shkodër | 48,4 | 50,6 | 49,2 | 44,4 | 45,7 | 48,8 | 44,1 | 46,3 | 44,9 |
| Tiranë | 4,7 | 6,5 | 4,2 | 6,1 | 5,5 | 6,1 | 5,9 | 7,2 | 6,9 |
| Vlorë | 23,7 | 22,4 | 25,2 | 26,8 | 27,2 | 23,7 | 28,8 | 30,8 | 29,3 |

| Qarqet | Industri | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr1.16 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 |
| Shqipëria | 19,1 | 19,1 | 19,6 | 19,5 | 19,0 | 19,0 | 19,4 | 20,0 | 19,7 |
| Berat | 14,8 | 17,7 | 18,9 | 16,7 | 16,3 | 14,3 | 17,8 | 17,9 | 14,7 |
| Dibër | 7,5 | 7,0 | 11,5 | 12,7 | 12,9 | 10,9 | 12,0 | 13,6 | 12,1 |
| Durrës | 34,7 | 35,5 | 35,7 | 35,4 | 35,4 | 39,8 | 37,6 | 35,9 | 35,2 |
| Elbasan | 12,5 | 10,3 | 9,8 | 10,0 | 8,5 | 7,8 | 10,4 | 10,3 | 9,6 |
| Fier | 9,8 | 11,8 | 11,9 | 9,8 | 8,9 | 10,5 | 11,6 | 13,0 | 11,8 |
| Gjirokastër | 20,9 | 27,2 | 27,7 | 21,0 | 17,8 | 13,8 | 14,8 | 17,4 | 15,1 |
| Korçë | 14,0 | 10,1 | 10,3 | 14,0 | 14,1 | 13,5 | 13,3 | 14,6 | 14,7 |
| Kukës | 5,1 | 6,3 | 7,9 | 10,3 | 12,5 | 12,5 | 10,4 | 11,2 | 7,4 |
| Lezhë | 18,3 | 17,8 | 19,0 | 20,3 | 17,7 | 18,5 | 21,3 | 20,5 | 19,6 |
| Shkodër | 17,8 | 16,5 | 17,8 | 21,5 | 19,8 | 16,4 | 19,2 | 19,4 | 19,0 |
| Tiranë | 25,7 | 26,6 | 27,1 | 25,0 | 25,1 | 25,5 | 24,9 | 26,0 | 26,5 |
| Vlorë | 28,5 | 25,7 | 25,3 | 26,6 | 30,1 | 27,2 | 25,5 | 25,6 | 24,3 |

| Qarqet | Shërbime | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr1.16 | Tr2.16 | Tr3.16 | Tr4.16 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.18 |
| Shqipëria | 40,1 | 40,5 | 40,3 | 40,8 | 42,0 | 42,7 | 42,7 | 42,4 | 42,7 |
| Berat | 19,4 | 19,5 | 19,8 | 24,1 | 28,0 | 29,7 | 29,6 | 29,4 | 23,8 |
| Dibër | 21,6 | 19,7 | 20,0 | 22,8 | 29,7 | 29,8 | 26,9 | 29,1 | 25,5 |
| Durrës | 40,4 | 43,9 | 43,6 | 41,1 | 44,3 | 43,6 | 47,6 | 48,2 | 50,1 |
| Elbasan | 24,3 | 24,4 | 24,4 | 26,2 | 26,8 | 27,3 | 25,8 | 27,7 | 22,2 |
| Fier | 25,1 | 27,7 | 29,2 | 26,5 | 27,6 | 27,5 | 26,7 | 25,0 | 24,7 |
| Gjirokastër | 38,9 | 28,8 | 25,2 | 31,7 | 37,6 | 34,9 | 44,2 | 41,7 | 44,9 |
| Korçë | 27,6 | 31,4 | 30,4 | 28,3 | 30,1 | 36,7 | 33,8 | 32,9 | 33,4 |
| Kukës | 26,5 | 21,7 | 19,1 | 22,9 | 26,0 | 29,2 | 25,8 | 30,5 | 30,0 |
| Lezhë | 46,0 | 45,5 | 40,2 | 39,6 | 37,2 | 35,7 | 39,6 | 43,6 | 46,5 |
| Shkodër | 33,8 | 32,9 | 33,0 | 34,0 | 34,5 | 34,7 | 36,7 | 34,3 | 36,2 |
| Tiranë | 69,4 | 66,9 | 68,7 | 69,0 | 69,4 | 68,3 | 69,2 | 66,8 | 66,6 |
| Vlorë | 44,2 | 51,9 | 49,5 | 46,2 | 42,8 | 49,1 | 45,7 | 43,6 | 46,4 |

# Metodologjia

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i saj është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

Baza e zgjedhjes e përdorur për ATFP bazohet në të dhënat përmbledhëse për zonat e numërimit sipas Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011. Madhësia e zgjedhjes për ATFP për tremujorin e parë të vitit 2018 është 7,944 familje. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure me dy hapa, ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit, dhe në hapin e dytë, brenda secilës prej këtyre zonave gjeografike zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks familjesh.

Për ATFP përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen saktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Në tremujorin e parë të vitit 2018, shkalla e përgjigjes së familjeve ishte 84,9 %.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Pyetësori i ATFP është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret e EUROSTAT. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientet e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetësorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.

Për procedurën e përgjithësimit të të dhënave të Anketës së Forcave të Punës përdoret popullsia e llogaritur mbi bazën e rezultateve të Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe ngjarjeve demografike (lindjet dhe vdekjet) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

**Të punësuar** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. **Java e referencës** është java kalendarike nga e hëna në të diel para datës së intervistës.

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është

punëtor stinor ose (b) personi merr 50 për qind ose më shumë të pagës; (3) të vetë-punësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtoret pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

**Të papunë** konsiderohen personat që ishin:

a) pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi;

b) aktualisht të gatshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës);

c) duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të vetin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifikë për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjenci private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmve, sindikatave etj,
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, licenca ose burime financiare

## Notë shpjeguese mbi treguesit kryesorë të tregut të punës

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

**Popullsia në moshë pune** është popullsia 15-64 vjeç.

**Forca e Punës** përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

**Popullsia jo-ekonomikisht aktive** përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

**Shkalla e punësimit** është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

**Shkalla e papunësisë** është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

## Cilësia e statistikave të tregut të punës

Treguesit kryesorë të tregut të punës vlerësohen nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Anketa është bazuar në një zgjedhje probabilitare prej 7,944 njësish ekonomike familjare. Zgjedhja e njësive ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë vlerësime sa më të sakta për treguesit kryesorë të tregut të punës. Pra, nga anketa mund të sigurohen vlerësime dhe jo shifra ekzakte për numrin e të punësuarve dhe të papunëve. Për çdo vlerësim që merret nga anketa llogaritet varianca e zgjedhjes për të parë se si do të ndryshonte vlerësimi nëse do të kryheshin zgjedhje të ndryshme të rastit me të njëjtin vëllim për të njëjtën periudhë, në vend të një zgjedhjeje të vetme. Kjo na lejon që të përcaktojmë kufijtë brenda të cilëve duhet të gjendet vlerësimi (që në terminologjinë statistikore njihet si intervali i besimit).

Në përgjithësi, sa më e vogël të jetë vlera e devijimit standard relativ të një vlerësimi aq më i lartë është niveli i saktësisë së vlerësimit. Në tabelën 7 paraqiten devijimi standard relativ dhe intervali i besimit për tre tregues kryesorë të tregut të punës për popullsinë 15-64 vjeç.

**Tab, 7 Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës**

| Treguesi | Vlerësimi (15-64 vjeç) | Devijimi standard | Devijimi standard relativ | Intervali i besimit për nivelin e besueshmërisë 95 % | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kufiri i poshtëm | Kufiri i sipërm |
| Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës | 68,0% | 0,1% | 0,1% | 67,9% | 68,1% |
| Shkalla e punësimit | 59,2% | 0,1% | 0,2% | 59,0% | 59,4% |
| Shkalla e papunësisë | 13,0% | 0,1% | 0,5% | 12,5% | 13,5% |

Shkalla e papunësisë për nivelin e besueshmërisë 95 % gjendet mes vlerave 12,5 % dhe 13,5 %, dhe ka një devijim standard relativ 0,5 %, Devijimi standard relativ për përpjesën e popullsisë 15-64 vjeç në punësim është 0,1 % dhe për nivelin e besueshmërisë 95 % vlerësimi për shkallën e punësimit gjendet mes vlerave 59,0% dhe 59,4 %.